

# DJEGIA E BIOMASËS: E ARDHMJA E LARGËT E SEKTORIT ENERGJITIK SHQIPTAR



## RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2023



AUTOR  
EDMORELA MYFTARAJ

QENDRESA  
QYTETARE



NED  
NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY  
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## Përmbajtje

Përmbajtje .....	2
1.Hyrje .....	3
2.Bioenergja në legjislacionin shqiptar .....	4
3.Kapacitete të shfrytëzuara .....	5
4.Impakti në mjedis .....	6
5.Kriteri i qëndrueshmërisë .....	8
6.Gjetje kryesore .....	9
7. Rekomandime .....	10



## 1.Hyrje

Bioenergjia si një burim i rinovueshëm i energjisë, shfrytëzon fuqinë e biomasës - lëndëve organike -për të gjeneruar karburante transporti, ngrohje, energji elektrike dhe produkte të ndryshme, duke kontribuar në përmbushjen e nevojave tona për energji nga burime të rinovueshme dhe miqësore me mjedisin.

Në kuadrin legjislativ shqiptar ka një sërë ligjesh rregullatore për fushën e bioenergjisë.Tanimë kjo fushë po shihet me prioritet si pasojë e nevojës për përafrim me legjislacionin evropian dhe ndjekjes së direktivave të BE.

Përqasja me politikat e gjelbra në Ballkan dhe më gjerë, si dhe firmosja e disa marrëveshjeve me objekt pikërisht nevojën për shfrytëzim të burimeve të rinovueshme dhe diversifikimin e tyre e bëjnë bioenergjinë një opion të konsiderueshëm.

Ndërkohë që ndjekja e politikave të gjelbra përkthehet në kusht dhe për integrimin në BE, implementimi i shfrytëzimit të këtij burimi për prodhimin e biokarburanteve për transport apo për energji elektrike, ka nevojë për analizim në kuadër të kapaciteteve mbështetëse dhe pasojave që mund të ketë në mjedis.

## 2. Bioenergjia në legjislacionin shqiptar

Energjia e krijuar nga biomasa luan një rol me rëndësi dhe në rritje për sa i përket sistemit energjitik global. Nisur nga përfitimet kryesore si ulja e emetimit të gazit të karbonit dhe reduktimi i ndotjes mjedisore në fusha si aviacioni, transporti, bioenergjia jep një kontribut relevant në vendet ku përdoret.

Agjendat e gjelbra, tanimë të njohura në Ballkan dhe më gjerë, po zbatohen me hapa të shpejta dhe në Shqipëri. Kuadri legjislativ për sa i përket bioenergjisë, shtjellohet në dy ligje kryesore: Ligji Nr.9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” dhe ligji nr.7 2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Këto dy ligje synojnë që përmes rregullimit të nxisin rritjen e prodhimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme dhe të sigurojnë qëndrueshmëri në sektorin energjitik duke ju përmbajtur dhe detyrimeve nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Synohet diversifikimi i energjisë dhe përdorimi i biomasës për të përfituar biokarburante.

Biokarburantet përkufizohen në ligj si lëndë djegëse në trajtë të lëngët dhe të gaztë, të përdorura për transport dhe të prodhuara nga biomasa. Disa lloje janë biodiezel, bioetanol, biogazi, biometanol, biodimetileteri etj.

Shumica e këtyre biokarburantëve përfitohen në gjendje të pastër ose përpunohen me nënprodukte të naftës nga njësitë e prodhimit të hidrokarbureve, të cilat janë persona juridikë sipas legjislacionit në fuqi. Këto persona juridikë duhet të përmbushin standardet e specifikuar në ligj për prodhimin. Veprimtaritë e importimit, të eksportimit dhe të tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierje me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto, realizohen nga njësitë e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme. Veprimtaria realizohet nga rafineritë e përpunimit të naftës bruto, të pajisura me “leje koncesioni” dhe nga shoqëritë e pajisura me “leje tregtimi” për tregtimin me shumicë të nënprodukteve të naftës.

### 3.Kapacitete të shfrytëzuara

Projektigji mbi prodhimin dhe transportimin e biokarburanteve ka pasur ndryshime të propozuara ndër vite dhe diskutime të shumta mbi relevancën. Deri më tani, pavarësisht linjës ambicioze të ndjekur në formulim dhe vendosjen e qëllimeve për reduktim të emëtimeve të CO2 dhe përafrimit me legjislacionin e BE, nuk ka pasur miratim të këtij projektligji.

Përsa i përket impianteve, rregullimi ligjor i parashikon të krijuara si shoqëri aksionare, të pajisura me licencë gjithashtu. Parashikohet që gjatë periudhës kohore të vlefshmërisë së licencës- shfrytëzimi i impiantit për prodhim të energjisë fillon pas verifikimit nga inspektorati shtetëror përgjegjës për përmbushjen e kushteve teknike. Nuk ka një përcaktim shterues mbi inspektoratin nëse është një strukturë ekzistuese apo do ketë një strukturë të re për ushtrimin e kësaj kompetence. Paqartësia në këtë drejtim është problematike pasi krijon konfuzion për kompanitë, shoqëritë tregtare që duan të investojnë në këtë drejtim.

Nga ana tjetër, ka një përcaktim mbi faktin që ky inspektorat i pa specifikuar në ligj, gjithashtu ushtron kontroll mbi subjektet juridike që prodhojnë apo transportojnë biokarburante. Kjo strukturë ka si detyrë dhe kontrollin mbi kriterin e qëndrueshmërisë. Por, në vetvete, do jetë një strukturë e vendosur nën varësinë e ministrit përgjegjës për hidrokarburet (Ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë). Kushtet dhe kriteret teknike do publikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nën këto rregullime, nuk ka informacione apo lista të qarta që parashikojnë kapacitetet e shfrytëzuara të impianteve që aktualisht funksionojnë në Shqipëri. Informacioni i vetëm lidhet me ndërtimin e një impianti në Lezhë mbi djegien e biomasës, i cili sipas burimeve të huaja, është ende në fazën e dhënies së lejes. Pritet që punimet mbi ndërtimin të nisin në vitin 2025.

Komisioni i BE-së thekson se zonat pyjore mbulojnë rreth 36% të sipërfaqes totale të vendit. Rezervat totale të drurit për ngrohje në Shqipëri vlerësohen rreth 6 Mtoe. Potenciali energjetik nga mbetjet bujqësore u llogarit rreth 43,000 Gë dhe potenciali energjetik nga mbetjet e kafshëve, si dhe për potacionet e mbetjeve bujqësore llogaritet rreth 70 toe/vit me një tendencë për të rritur në të ardhmen.

Potenciali i mbetjeve urbane nga qytetet kryesore shqiptare u llogarit si rreth 405615 Tonne me një tendencë për të rritur në të ardhmen. Biomasa dhe shfrytëzimi i saj për prodhimin e energjisë elektrike ende nuk konsiderohet si opsion nga politikat shqiptare, megjithëse përfshihet si nocion në planet dhe strategjitë për ndjekjen e agjendës së gjelbër. Shqipëria nuk prodhon biokarburante.<sup>1</sup>

## 4. Impakti në mjedis

“Emetimet e gazeve serrë janë rritur ndjeshëm në sektorin e transportit gjatë dekadës së fundit. Përdorimi i biokarburanteve si një alternativë ndaj lëndëve djegëse fosile në transport mund të ndihmojë për të reduktuar këto emetime dhe për të rritur sigurinë energjetike, prandaj biokarburantet janë bërë pjesë e politikës së BE-së për klimën dhe energjinë. Në vitin 2021 pothuajse 93% e energjisë së përdorur në transportin rrugor dhe hekurudhor në BE erdhi nga lëndët djegëse fosile.” Sipas një raporti të vitit 2023 nga BE, vendosja e targeteve për përdorimin e biokarburanteve nuk është plotësuar nga të gjitha shtetet dhe se ka pasur kompleksitet politikash si rezultat i ndryshimeve të shpeshta.<sup>2</sup>

Për sa i përket vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, biokarburantet përbëjnë rreth 89% të energjisë së rinovueshme të shfrytëzuar për sektorin e transportit. Gjithashtu direktivat e implementuara caktojnë për shtetet anëtare targetin specifik prej 14% për përdorimin e burimeve të rinovueshme në transport deri në vitin 2030.<sup>3</sup>

Objektivat kombëtare janë përcaktimi i sasisë minimale vjetore në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport; nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve; garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit; kontributi në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit; zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë si stimul për zhvillimin rural dhe nxitje të punësimit duke respektuar kriterin e qëndrueshmërisë; ulja e sasisë së

<sup>1</sup> <https://cordis.europa.eu/article/id/124474-renewable-energy-potentials-of-albania>

<sup>2</sup> [https://www.energy-community.org/dam/jcr:3f7e7552-a24e-43be-8031-039856b91444/RESProgressReport\\_Albania-2020-2021.pdf](https://www.energy-community.org/dam/jcr:3f7e7552-a24e-43be-8031-039856b91444/RESProgressReport_Albania-2020-2021.pdf)

<sup>3</sup> <https://www.epure.org/wp-content/uploads/2023/02/230227-DEF-REP-Overview-of-biofuels-policies-and-markets-across-the-EU-February-2023-1.pdf>

emetimeve të ndotësve në ajër dhe të emetimeve të gazeve me efekt serrë, të çliruara nga veprimtaritë në sektorin e transportit.

Raporti nxjerr në pah se në drejtim të shfrytëzimit të biomasës, nuk ka asnjë masë konkrete, për vitin 2020 dhe 2021, niveli i shfrytëzuar është 0.

- Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë, nëpërmjet përdorimit të biokarburanteve dhe biolëngjeve, duhet të jetë të paktën 35%.<sup>4</sup>
- Plani Kombëtar për Burimet e Rinovueshme ka vendosur synim që brenda vitit 2030, 54% e energjisë të prodhohet nga burime të rinovueshme.

Në tabelën e mëposhtme, është analizuar prodhimi i bioenergjisë për Shqipërinë. Paradoksal është fakti që nuk ka asnjë tregues që prodhohet bioenergji por vetëm sasi të importuar. Nga një kërkesë për informacion nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, rezultoi nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve se MIE nuk ka licencuar asnjë impiant për prodhimin e biokarburanteve për dy vitet e fundit.

**Table 1d: Total actual contribution from each renewable energy technology in [Albania] to meet the binding 2020 targets and the indicative interim trajectory for the shares of energy from renewable resources in the transport sector (ktoe)<sup>19, 20</sup>**

	0	0
Bioethanol/ bio-ETBE		
<i>Of which Biofuels<sup>21</sup> Article 21.2</i>		
<i>Of which imported<sup>22</sup></i>	120	115
Biodiesel (ktoe)		
<i>Of which Biofuels<sup>23</sup> Article 21.2</i>		
<i>Of which imported<sup>24</sup></i>		
Hydrogen from renewables		
Renewable electricity		
<i>Of which road transport</i>		
<i>Of which non-road transport</i>	120	115
Others (as biogas, vegetable oils, etc.) – please specify		
<i>Of which Biofuels<sup>25</sup> Article 21.2</i>	<b>120</b>	<b>115</b>
<b>TOTAL</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

<sup>4</sup> [RENJK 199 Raporti i Vlerësimit të Ndikimit biokarburantet.docx](#)

## 5.Kriteri i qëndrueshmërisë

Shqipëria është përfshirë në procesin e krijimit të një tregu të brendshëm mbështetës në fushën e energjisë dhe në garantimin e sigurisë dhe efikasitetit të energjisë.

Ligji ekzistues që prej vitit 2008 është inkorporuar në legjislacionin shqiptar si detyrim i Shqipërisë ndaj Direktivës 2003/30/KE. Më tej janë bërë ndryshime ku ndër to gjendet dhe shtimi i kriterit të qëndrueshmërisë ( i parashikuar në nenin 9 të ligjit nr.9876/2008), sipas Direktivës 2009/28/KE. Kjo Direktivë synon promovim të burimeve të rinovueshme dhe ndjekjen e disa parametrave të përbashkët, vendosjen e një targeti të detyrueshëm prej 20% të konsumit të energjisë në energji të rinovueshme.

Ndryshimi më i fundit i ligjit , ofron një përshtatje të pjesshme me Direktivën 2018/2011 KE e cila shfuqizon Direktivën 2009/28 KE.Direktiva e riformuluar e zhvendos kuadrin ligjor në vitin 2030 dhe përcakton një objektiv të ri detyrues për energjinë e rinovueshme për BE-në për vitin 2030 prej të paktën 32%, me një klauzolë për një rishikim të mundshëm deri në vitin 2023, dhe përfshin masa për sektorë të ndryshëm për ta realizuar atë.

Ndryshimet që pasojnë në vendosjen e kriterëve të qëndrueshmërisë dhe objektivave për përdorimin e burimeve të rinovueshme në transport, janë thelbësorë për zbatimin e detyrimeve në kuadër të përafrimit me legjislacionin evropian.

Ligji parashikon operatorë ekonomikë për verifikimin e kushteve të qëndrueshmërisë por mbetet e paqartë nëse do ti delegohet AKBN apo një strukturë të posacme dhe sesi do funksionojë kjo e fundit. Nesë bëhet fjalë për një operator të ri, rregullimi duhet të ishte tanimë i përfunduar duke qenë se kriteret e qëndrueshmërisë janë në fuqi që nga 1 janari i vitit 2024. Referohet detyra e specifikimit të realizimit të kontrollit sipas udhëzimeve të Ministrisë Përgjegjëse por nuk ka ende një referim të saktë.



Tregtimi i biokarburanteve për një periudhë prej 10 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi e ligjit do të jetë i përjashtuar nga regjimi fiskal në Shqipëri vetëm për sasinë e biokarburanteve të pastra (100% bio dhe jo për pjesën e nënproduktet respektive të prodhuar nga përpunimi i naftës bruto), të cilat plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë.

## 6. Gjetje kryesore

1. Ligji ka paqartësi në parashikimin mbi organin apo Agjensinë përgjegjëse e cila do të evaluojë kriteret teknike që duhen përmbushur nga njësitë prodhuese të biokarburanteve.
2. Industria e bioenergjisë është inekzistente në Shqipëri. Pavarësisht impenjimit të BE përmes sugjerimeve për implementim të politikave të gjelbra dhe potencialit ekzistues, bioenergja dhe biokarburantet nuk lëvrohen në vendin tonë si opsion i mirë për reduktim të importit dhe krijimin e një industrie që shkon drejt synimeve të gjelbra. Në linjë me këtë gjetje është dhe fakti që nuk ka ende një matje konkrete apo avancim në drejtim të qëllimit për arritjen e përdorimit të 10% të këtyre burimeve për transportin.
3. Synimi për të zëvendësuar karburantin në fushën e transportit me biokarburante mbetet një synim i largët. Qëllimi i ligjeve për të nxitur përdorimin e biokarburanteve dhe për të ulur në këtë formë emëtimet e CO<sub>2</sub> ngelet një objektivi i paarritur.
4. Objektivat dhe synimet e qeverisë shqiptare për sektorin energjitik mbeten të parrrealizuara në linjën e vitalizimit të sektorit të bioenergjisë.

## 7. Rekomandime

1. Shtysa për favorizimin e investimeve publike dhe private në krijimin e impianteve për prodhimin e biokarburanteve.
2. Duhet të ruhet raporti i drejtë i prodhimit të bioenergjisë me shfrytëzimin dhe efektin në mjedis, nëse do arrihet implementimi i qëllimeve për të krijuar një sektor bioenergjitik. Duhet të synohet vendosja e qëllimeve për ruajtjen e një niveli balancues të prodhimit të CO<sub>2</sub>.
3. Rekomandohet fuqizimi i agjensive shtetërore të cilat kanë kompetencë kontrollin dhe licencimin e shoqërive tregtare për prodhim të biokarburanteve, duke nisur nga legjislacioni më i elaboruar dhe i qartë. Ndjekja e rekomandimeve të standardeve evropiane do ta lehtësonte këtë proces dhe do ishte një hap konkret dhe ndaj integritimit.
4. Shqipëria duhet të zhvillojë mekanizma të qëndrueshëm për shfrytëzimin e energjisë së gjelbër për të arritur qëllimet e qëndrueshmërisë. Kjo mbetet një sfidë për të gjitha vendet, përfshirë shtetet anëtare të BE-së, por Shqipëria duhet të angazhohet në hartimin e mënyrave efektive për përdorimin e biokarburanteve dhe për të siguruar një ekuilibër të qëndrueshëm në shfrytëzimin e burimeve të energjisë së gjelbër.

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)